





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 20/OPK Nr. Prot. 01-3495/14
Dep. 02 Br. Prot. 08.10.2014
Nr. i faq. 02 Datum 08.10.2014
Broj stranica 02 Date 08.10.2014
Nr. pages 02 PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni –  Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



Të nderuar,

Lidhur me kërkesën, për shqyrtimin e situatës së konfliktit të interesit lidhur me Vendimin e Komisionit Përzgjedhës në Universitetin "Fehmi Agani" të Gjakovës, për pranim në vendin e punës "biblotekiste", në mbështetje të nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,

NJOFTOHENI se:

Agjencia kundër Korrupsionit në kuadër të kompetencave të veta lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.); *"ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe korrupsionit në tërësi"*, (Neni 19, pika 1.6, e Ligjit Nr.04/L-051), dhe në bazë të kësaj kemi nxjerr këtë :

OPINION:

NUK KA KONFLIKT INTERESI në rastin e pranimit në punë të znj. Arbresha Morina në pozitën e bibliotekistes në Universitetin “Fehmia Agani” të Gjakovës.

Nga Raporti për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për pozitën e punës “biblotekist/iste” (DPK/DPKI-03-3332-14) shihet se pranimi i znj. Arbresha Morina në këtë pozitë është bërë pas vlerësimit të testimit me shkrim dhe me gojë që, kandidatëve të paraqitur, i ka bërë Komisioni në përbërje të plotë prej; Visar Muçaj Sekretar në Fakultetin e Mjekësisë në UP-kryetar, Fidan Hamiti, menaxher i personelit në UP-anëtar, Linda Dula, zyrtare e personelit në UGJFA-anëtare, Nuriye Halilaj, asistente në zyren e Rektorit të UGJFA-anëtare, Rina Rudi, zyrtare për financa në UGJFA-anëtare.

Nuk qëndron dhe nuk ka bazë në ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit pretendimi i juaj se kandidatja e pranuar ka konflikt interesi për shkak se vëllau i saj është Anëtar i Bordit të këtij Universiteti.

Do të ishte konflikt interesi sikur vet Anëtari i Bordit (vëllau i kandidatës), në një apo në mënyrë tjetër të ishte pjesë e panelit intervistues ose vendimmarrës për këtë pozitë pune.

Por, përderisa vëllau i saj nuk ka pasur kurrfar lidhje me procesin e rekrutimit, selektimit dhe përzgjedhjes, së kandidatëve në këtë konkurs, atëherë kandidates nuk mund t'i mohohet e drejta për themelimin e marrëdhënjes së punës duke u thirrur në konflikt interesi. Në këtë situatë (të procesit të konkurimit) nuk është shumë relevante fakti se kandidatja dhe një nga anëtarët e Bordit të Universitetit janë motër e vëlla.

Kjo lidhje do të ishte relevante edhe do të kishim shkelje të normave të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit, atëherë kur dikush nga anëtarët e komisionit intervistues do të deklaronte se Anëtari i Bordit të Universitetit të Gjakovës, në këtë rast z. Arber Morina, ka bërë këto veprime:

- ka krijuar marrëdhënie varësie nga persona të tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimarrje.
- ka ndikuar në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material apo personit në lidhje me te,
- ka ndikuar në vendimarrje të organeve legislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e tij prej zyrtari me qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërtë apo të besueshëm.
- ka ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik.

Agjencia Kundër Korrupsionit u është mirënjohës për bashkëpunimin tuaj dhe ju inkurajon që të vazhdoni këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Me respekt,